



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 120, Datë 09/09/2019

Mbështetur në nenin 41/1/2¹ të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurën administrative për trajtimin e ankesës nr. 102, datë 29.08.2019, të Fondacionit Down Sindrome Albania, ku pretendohet diskriminim i individëve që vuajnë nga Sindromi Down, për shkak të “*aftësisë së kufizuar*” dhe “*predispozicionit gjenetik*”, nga ana e Z. M.M., me detyrë Deputet dhe Nënkyetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Në përfundim të procedurës administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar informacionit të përcjellë nëpërmjet ankesës së mësipërme rezulton se në një postim në faqen personale, në rrjetin social Facebook, Z. M.M. duke debatuar me komentuesit e tij, ka përdorur termin “Down” në mënyrë ofenduese. Komenti i Z. M.M. daton në 26.08.2019 dhe citohet si vijon: “*B. M. pse ashtu e kupton ti si intelektual??? O pika që nuk ju bie. Pse kjo*”

¹ Neni 41, pikat 1 e 2, Kodi i Procedurave Administrative: “1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë. 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik”.

ndrikulla është problem apo rama, damiani, beqa, kajmaku valdrini??? Ik qërrohu se më vjen për të vjellë kur shoh që një down komenton në fb tim”.

Për sa më sipër, Fondacioni Down Syndrome Albania e konsideron tepër diskriminuese, gjuhën e përdorur nga ana e Z. M.M., ndaj personave që vuajnë nga sindroma Down dhe kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, marrjen e masave përkatëse në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me aftësinë e kufizuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- A.** Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 102, datë 29.08.2019, së Fondacionit Down Syndrome Albania, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

B. Në datën 30.08.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi publikoi një Deklaratë për Mediat, në rrjetin social Facebook, ku është shprehur se dënon gjuhën diskriminuese të përdorur nga zyrtarë të lartë publikë dhe se pret një reagim të menjëhershëm të personave publikë, që kanë përdorur gjuhë diskriminuese, duke kërkuar falje publike.

Në vijim, në datën 03.09.2019, Z. M.M. ka reaguar, duke kërkuar falje publike në një Deklaratë për Mediat, të dhënë në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me shprehjen e përdorur në postimin e tij në rrjetin social Facebook, fakt ky që është marrë në konsideratë dhe është vlerësuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi ky veprim reflekton pendesë për shprehjen e përdorur.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se reflektimi i Z. M.M. dhe sqarimi i situatës konkrete, është një veprim i ndërmarrë jo vetëm në sajë të inisiativës së tij personale dhe në kushtet e pozicionit të lartë, që ai mban pranë Kuvendit të Shqipërisë, por edhe në sajë të qëndrimit, rolit dhe reagimit tepër të fuqishëm të institucioneve që mbrojnë të drejtat e njeriut, OJF-ve dhe shoqatave të ndryshme, që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, veprimtaria e të cilave vlerësohet maksimalisht nga ana e institucionit të KMD-së.

Theksojmë se, Komisioneri ka patur dhe ka vazhdimisht në vëmendjen e vet, faktin që përdorimi i rrjeteve sociale për të bërë publike qëndrime verbale, opinione apo veprime konkrete të personave të caktuar publikë apo subjekteve të ndryshme politike, të jetë i kujdesshëm dhe të mos ndikojë negativisht apo si fyerje ndaj asnjë komuniteti apo grupi vulnerabël.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të cenohet dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” të jenë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.*

Gjuha e urrejtjes për qëllim të Rekomandimit CRI(2016)15 përfshin përdorimin e një ose të disa formave më të veçanta të shprehjes – si psh, mbrojtjes, promovimit apo nxitjes së denigrimit, urrejtje apo shpifje të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip

negativ, stigmatizim apo kërcënim i një personi ose disa personave dhe çdo justifikim të të gjithë formave të shprehjes - që është i bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale ose statusin që përfshin "raca", ngjyra, gjuha, feja apo besimi, kombësia apo origjina kombëtare ose etnike, si prejardhja, moshja, aftësia e kufizuar, seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual³.

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 1, sanksionon: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Në kuadër të ushtrimit tëtributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, si dhe përmbushjes së qëllimit të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar edhe raste të tjera të përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga persona publik.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese, diskriminuese, denigruese, përçmuese, stigmatizuese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar si masë rregulluese nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, heqjen e deklaratës apo komentit dhe ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

Në kushtet kur Z. M.M. ka kërkuar ndjesë publike, Komisioneri gjykon se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ bazuar në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është përmbushur.

³ Përkthim i Komisionerit. ECRI General Policy Recommendation No.15 “On combating hate speech” CRI (2016)15. Adopted on 8 December 2015. B.9 Definition (s).

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe nenit 90, pika 2 dhe 3 të Kodit të Procedurave Administrative Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për ankesën nr. 102, datë 29.08.2019, e Fondacionit Down Sindrome Albania, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha - te mira dhe sherbime
Shkak - aftesi e kufizuar